

**FEDERATA E BOKSIT
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +381 38 247 578, Mob:+383 44112824 +38344 208 215, E-mail: fboxk@hotmail.com

Acc No: 1701001010850503 NLB Prishtinë

Adress: Str. Agim Ramadani No. 43, House of Sport 10000 Pristina

STATUTI

I FEDERATËS SË BOKSIT TË KOSOVËS

PRISHTINË 2022

Në bazë të Ligjit Nr.04/L-075 për sport të Kosovës, Udhëzimit administrative të akteve nënligjore të DS të MKRS-së ,Nr.06/L-043 për Lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare Kuvendi i Federatës së Boksit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 05.05.2022 aprovoi këtë:

STATUT TË FEDERATËS SË BOKSIT TË KOSOVËS

-I- DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Federata e Boksit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Federata ose FboxK), është asociacion i pavarur sportiv, OJQ , i cili bashkon të gjithë boksier\t, trajnerët, gjyqtarët, veprimtarët, drejtuesit e boksit si dhe dashamirët e këtij sporti në Kosovë nëpërmjet klubeve, pa marrë parasysh gjininë, ngjyrën, gjuhën, fenë, mendimin politik apo opinionion e tij, prejardhjen sociale apo etnike, lidhjen me bashksinë etnike pronën apo lindjen si dhe mbron qëllimin, realizimin e të drejtave, detyrave, obligimeve dhe programeve mbi bashkimin e të interesuarve të përcaktuar me këtë Statut.

Neni 2.

Federata e Boksit e Kosovës është person juridik. FboxK inicon, organizon, drejton dhe kontrollon veprimatrinë e boksit mbi bazën e parimeve dhe direktivave e Regullave të EUBC dhe IBA.

Neni 3

Emri i federatës është FEDERATA E BOKSIT E KOSOVËS, shkurtesa është FBOXK. Selia e federatës është në Prishtinë. Federata vepron në territorin e Kosovës. Federata është person juridik dhe vepron në pajtim me Statutin e EUBC dhe IBA, Ligjin për Sport dhe Ligjin mbi Organizatat jofitimprurëse.

Neni 4.

Simboli i parë i FboxK-së është shenja e Federatës e cila përbëhet nga harta e Kosovës ringu dy doreza ne balline shqiponja dykrenare dhe shkurtesa FboxK.

Neni 5

Flamuri i FboxK-së ka formën sikur edhe simboli (materiali i mendafshhtë).

Neni 6

Vula e FboxK-së është e rumbullakët, me shenjë të Federatës në mes dhe mbishkrimin: FEDERATA E BOKSIT E KOSOVËS ne gjuhen shqipe dhe angleze.

Neni 7.

Federata është anëtare e Komitetit Olimpik të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KOK). Federata është antare e EUBC dhe IBA. Federata punon në bazë të akteve normative të veta, të cilat janë të harmonizuara me ato te EUBCse, IBA-se dhe KOK-ut. Federata mund të anëtarësohet edhe në asociacione të tjera sportive vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 8.

PËRFAQËSIMI DHE NËNSHKRIMI

Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm, ose Nënkyetari dhe Sekretari i Përgjithshëm, mund të nënshkruajnë bashkërisht në emër të FBOXK-së, përfaqësojnë, propozohen për organe drejtuesenë asambltetë e Federatës Botërore, Evropiane, KOK, përfaqësojnë FBOXK në takime të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, gara vendore dhe ndërkombëtare etj.

Neni 9.

FboxK-ja bashkëpunon dhe vepron me Fakultetin e Kosovës Fizike, Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike, Shoqatat e trajnerëve, gjyqtarëve si dhe asociacione të tjera jo vetëm sportive të cilat dëshirojnë këtë bashkëpunim.

Neni 10.

FboxK-ja përgjigjet për obligimet e marra me të gjitha mjetet e saja: FboxK-ja e ka xhirollogarinë e vet.

Neni 11.

Federata e njofton opinionin publik për punën e saj nëpërmjet: Buletinave (Informatorëve), mjeteve të informimit si dhe nëpërmjet organizimit të konferencave për media.

Anëtarët e vet i njofton nëpërmjet:

- Procesverbaleve të mbledhjeve të organeve dhe komisioneve,
- Buletinave dhe publikimeve tjera dhe
- Mjeteve të informimit.

-II- QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA E FEDERATËS

Neni 12.

Qëllimet e federatës janë: masovizimi, zhvillimi kualitativ dhe organizimi i boksit, udhëheqja e garave zyrtare dhe garave të tjera,

1. Udhëheqja me reprezentacionet boksit të Kosovës,
2. Organizmi dhe përparimi profesional i boksierëve, trajnerëve, referëve, delegatëve,
3. U ndihmon organizatave të tjera në promovimin e boksit në të gjitha fushëveprimet e sportit të boksit, në përputhje me aktet normative.
4. Merr pjesë në manifestime dhe gara ndërkombëtare,
5. Mbështet zhvillimin e boksit në vise të pazhvilluara,
6. Merr pjesë në punën e AOK-ut dhe asociacioneve tjera sportive,
7. [Ligji nr. 05/1-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive](#)
8. Vepron kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e AOK-ut dhe EABA dhe IBA.
9. Merr pjesë në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me boksit.

-III- ANËTARËT E FEDERATËS

Neni 13.

Anëtarë të federatës janë: Klubet e boksit (publike dhe private), Shoqatat e trajnerëve, gjyqtarëve, e boksierëve dhe të gjitha shoqatat tjera, të cilat do të pranohen nga federata.

-Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për anëtarësim në federatë janë:

1. Certifikata e OJQ kopje
2. Vërtetimi për regjistrim e klubit në Komunën përkatëse.
3. Vërtetim të personit të autorizuar të klubit nga OJQ,
4. Vërtetim nga gjykata për përfaqësuesin e klubit që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë.
5. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore nga ATK-ja
6. Një kopje të vlefshme të stautit konfor statutit të FBOXK
7. Një kopje të vlefshme të rregulloren e kuvendit
8. Një kopje të vlefshme të rregulloren e bordit
9. Një kopje të vlefshme të rregulloren disiplinore
10. Klubi duhet të ketë llogari bankare aktive.
11. Klubi duhet të ketë logon e saj.
12. Klubi duhet të ketë flamurin e saj.
13. Klubi duhet të ketë vulën e saj.
14. Respektimi i Statutit dhe të gjitha akteve normative të FboxK-së
Sekretariati i Përgjithshëm verifikon përmbushjen e kërkesave të parashikuara në këtë statut dhe përgatit një raport me shkrim për Bordit.
15. Bordi do të shqyrtojë raportin me shkrim dhe do të vendosë nëse kërkesa për anëtarësim i plotëson të gjitha kërkesat dhe sipas statutit të FBOXK,
16. Bordi e pranon anëtarin me të drejta të përkohshme dhe i mundëson pjesëmarrje në gara deri në kuvendin e radhës.
17. Bordi i kërkon Kuvendit të Përgjithshme të pranojë ose jo klubin pasi që klubi të ketë plotësuar të gjitha kërkesat dhe sipas statutit të FBOXK.
18. Pranimin e klubit e bën Kuvendi me shumicë (50% plus 1) e delegatëve të kuvendit me të drejtë vote
19. Antaret mund të përjashtohen nga federata kur i shkel dispozitat e statutit dhe akteve tjera normative të federatës.
20. Nuk zbaton apo injoron vendimet e obligueshme të federatës me veprimet e veta demton imazhin e federatës
21. Nëse konstatohet se klubi i antarsuar në FBOXK nuk ushtron veprimtarinë e saj apo konstatohet se gjatë dy viteve të fundit nuk e ka mbajtur kuvendin dhe nuk ka marrë pjesë në gara të rregullta.
22. Vendimin për përjashtim nga anëtarësia e bën Kuvendi, Efektet e përjashtimit veprojnë nga dita e marrjes së vendimit.
23. Antarsia konsiderohet e ndërprerë për të gjitha klubet që nuk marrin pjesë në gara për 2 vite.
24. Përjashtimi i klubit e bën Kuvendi me shumicë (50% plus 1) e delegatëve të kuvendit me të drejtë vote.

Neni 14.

Zhvillimi i aktivitetit në lëmin e boksit, punëtorëve sportiv dhe anëtarëve tjerë të cilët me vullnet të lirë janë të bashkuar realizohet në ekipet - klubet e boksit.

Klubet e boksit janë anëtarë të FboxK në territorin ku e ushtrojnë veprimtarinë sportive. Klubet e boksit, të cilat janë të themeluara dhe të regjistruar në organet përkatëse komunale, të cilat posedojnë me infrastrukturë të nevojshme, kuadër profesional, dhe se posedojnë vertetimin me shkrim për regjistrim si klub sipas rregullores mbi regjistrimin e Fboxk dhe Statutit të FboxK-së.

Neni 15

Si forma të organizimit dhe ndikimit në Federatë mund të themelohen Shoqatat e gjyqtarëve dhe trajnerëve të boksit, të cilat realizojnë të drejtat, detyrat dhe interesat e tyre të përbashkëta konform dispozitave të këtij Statuti, dispozitave tjera të Federatës, të IBA-se dhe Akteve të tyre normative.

Neni 16.

Shoqata e gjyqtarëve dhe trajnerëve të boksit të Kosovës si Shoqata profesionale të Federatës, zbaton politikën në kahje të vendimeve të aprovuara nga organet e Federatës. Rregulloret e Shoqatës së gjyqtarëve dhe asaj të trajnerëve nuk duhet të jenë në kundërshtim me dispozitat e këtij Stati

Neni 17.

Aktiviteti sportiv i gjyqtarëve të boksit, mbështet në baza të amatorizmit, ndërsa kompenzimi për kryerjen e detyrës së gjyqtarit rregullohet me akte të veçanta normative dhe për këtë vendos Bordi i FBOXK-se

Neni 18.

Trajnerët dhe punëtorët tjerë profesional i realizojnë të drejtat dhe obligimet e tyre drejtë për së drejti në klubet e boksit - klubet e tyre qoftë të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune, qoftë në baza amatore.

Trajnerët për të punuar në klubet e boksit duhet t'a kenë kualifikimin përkatës të lëshuar nga organi kompetent i FBOXK-së.

Lëshuarja dhe marrja e lejës - licencës për ushtrimin e veprimtarisë së trajnerit më për së afërmi rregullohet me aktet normative të Shoqatës së trajnerëve dhe Rregullores mbi punën profesionale në FBOXK.

Neni 19.

TË DREJTAT E ANËTARËVE dhe DETYRIMET E ANËTARËVE

1. Anëtarët e FBOXK-së gëzojnë të drejtat e mëposhtme:
2. Të marrin pjesë në Kuvendin e Përgjithshme, të njihen më parë me rendin e ditës së çdo Kuvendi të Përgjithshme, të ftohen në Mbledhjen e Kuvendit të Përgjithshme në kohën e përcaktuar, të ushtrojnë të drejtën për të diskutuar dhe debatuar në Kuvend dhe të ushtrojnë të drejtën për të votuar. E aplikueshme për anëtarët me të drejt vote.
3. Të paraqesin propozime për t'u përfshirë në rendin e ditës së Kuvendit të Përgjithshme. E aplikueshme për anëtarët me të drejt vote.
4. Të propozojnë kandidatë për zgjedhje dhe/ose emërim në organet përkatëse të FBOXK-së . E aplikueshme për anëtarët me të drejt vote siç e parasheh ky statut.

5. Të informohen për çështjet e FBOXK-së përmes organeve të saj zyrtare dhe të informohen për vendimet e marra nga Bordi ;
 6. Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe/ose aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FBOXK-ja dhe të organizojnë gara tjera pasi ti ipet e drejte nga FBOXK--ja dhe nën kujdesin e saj;
 7. Të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tjera që burojnë nga statuti dhe në përputhje me rregulloret dhe vendimet e FBOXK--së;
 8. Të nxjerrin rregullore vetëm në lidhje me funksionin e tyre administrativ, organizimin dhe autoritetin territorial (nëse është e rëndësishme).
 9. Ushtrimi i këtyre të drejtave i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të tjera në këtë statut dhe në rregulloret e zbatueshme të FBOXK--së.
- Anëtarët e FBOXK -së kanë detyrimet e mëposhtme:
10. Të jenë besnikë ndaj FBOXK së, që do të thotë se ata nuk duhet të veprojnë kundër interesave të saj;
 11. Të respektojnë plotësisht statutin, rregulloret, vendimet e FBOXK -së ,Komisioneve në çdo kohë dhe të sigurojnë që ato të respektohen edhe nga anëtarët, triatletët dhe zyrtarët e tyre;
 12. Të sigurojnë zgjedhjen e organeve vendimmarrëse të paktën çdo 4 vjet;
 13. Të mbledhin organin e tyre më të lartë dhe legjislativ në intervale të rregullta, si rregull i përgjithshëm një herë në vit;
 14. Të marrin pjesë në gara (nëse është e zbatueshme) dhe aktivitete të tjera sportive të organizuara nga FBOXK -ja;
 15. Të paguajnë kootizimine anëtarësisë dhe të jenë të qëndrueshëm sa u takon detyrimeve të tyre financiare, siç përcaktohet në këtë statut, rregulloret ose me vendimin e Bordit të FBOXK -së;
 16. Të respektojnë Rregulloren e garave të përcaktuara nga FBOXK -së, dhe të sigurojnë që ato të respektohen gjithashtu nga anëtarët e tyre, triatletë dhe zyrtarët përmes një dispozite posaçme në statutet e tyre;
 17. Të miratojnë një klauzolë ligjore, statutore ku specifikohet që çdo mosmarrëveshje e nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FBOXK -së mund të referohet në shkallën e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme Brenda FBOXK) vetëm në CAS në Kosovë ,CAS në Lozanë e cila do të zgjidhë çështjen në mënyrë përfundimtare duke përjashtuar çdo gjykatë të juridiksionit të zakonshëm, me përjashtim kur një gjë e tillë ndalohet shprehimisht nga legjislacioni i Republikës së Kosovës;
 18. Të sigurojnë që organet e tyre të zgjidhen ose të emërohen në përputhje me një procedurë që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ;
 19. Të komunikojnë FBOXK -së çdo ndryshim në statutin dhe rregulloret e saj, si dhe listën e zyrtarëve të saj, të cilët janë përfaqësues ligjorë me të drejtën për të lidhur marrëveshje ligjërish të detyrueshme me palë të treta;
 20. Të mos mbajnë asnjë marrëdhënie të natyrës sportive me subjektet që nuk njihen ose me anëtarët që janë pezulluar ose përjashtuar;
 21. Të respektojnë parimet e besnikërisë, integritetit dhe sjelljes së mirë sportive si shprehje në gatat e ndershme përmes një dispozite statutore dhe të sigurojnë që këto parime të respektohen edhe nga anëtarët e tyre përmes një dispozite të posaçme statutore;
 22. Të administrojnë një regjistër të anëtarëve, i cili të përditësohet rregullisht;
 23. Të pajtohen plotësisht me të gjitha detyrimet e tjera që rrjedhin nga statuti dhe rregulloret e tjera të FBOXK.
 24. Anëtarët duhet të integrojnë në statutin e tyre detyrimet e përmendura më sipër, për të qenë të zbatueshme për anëtarët e tyre.
 25. Të respektojë [Ligji nr. 05/1-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.](#);

-IV- ORGANET E FEDERATËS

Neni 20.

Organet e federatës janë:

- Kuvendi
- Bordi
- Kryetari
- Këshilli Mbikqyrës

-V- KUVENDI

Neni 21.

Kuvendi është organi më i lartë i federates, i cili përbëhet prej anëtarëve të autorizuar të klubeve dhe Shoqatave të federatës.

Klubet përfaqësohen me nga 1 (një) delgatë, kurse Shoqatat përfaqësohen në Kuvendin e federatës me nga 1 (një) delegat.

Në mbledhjet e Kuvendit mund të marrin pjesë delegatët e autorizuar dhe mysafirët e ftuar pa të drejtën e votës.

Neni 22.

Mbledhjet e Kuvendit mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Kuvendi i rregullt mbahet çdo vit, e thërret kryetari ose Bordi i FboxK-së. Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërrasin kryetari, 2/3 e anëtarëve të Kuvendit, 2/3 e anëtarëve të Bordit dhe Këshilli Mbikqyrës.

Ftesa duhet të dërgohet më së largu 14 ditë para mbledhjes, ndërsa materiali, 7 ditë para Kuvendit.

Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të vendosë vetëm për çështjet për të cilat është thirrur.

Kuvendin e jashtëzakonshëm duhet ta konvokoj kryetari, në afat prej 30 ditëve prej ditës së kërkesës, në të kundërtën, Kuvendin mund ta konvokoj edhe inicuesi.

Neni 23.

Kuvendi mund të bie vendime në qoftë se janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 24.

Kuvendi e zgjedh kryesinë e punës, procesmbajtësin, komisionin verifikues dhe në qoftë se ka nevojë edhe trupa tjera punuese.

Në mbledhje mbahet procesverbali, të cilin e nënshkruajnë kryetari, anëtarët e kryesisë së punës dhe procesmbajtësi.

Kuvendi merr vendime me shumicën e anëtarëve present, të cilët e kanë të drejtën e votës.

Në qoftë se vendoset për ndryshimet statutare, ose për pushimin e punës së federates, për një gjë të tillë duhet të votojnë 2/3 e anëtarëve present.

Votimi është publik në qoftë se Kuvendi nuk vendos ndryshe. Kuvendin e udhëheq kryesia e punës, të cilën e përbëjnë: kryetari i federatës dhe dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi.

Vendimet e Kuvendit janë të obligueshme për të gjithë anëtarët dhe organet e federatës.

Procedura dhe mënyra e punës së Kuvendit, më përafërsisht rregullohen me Rregulloren e punës së Kuvendit

Neni 25.

Shpenzimet e pjesëmarrjes në mbledhje të Kuvendit i bartë vet anëtari i Kuvendit.

Neni 26.

Kuvendi në fushëveprimtarinë e vet i kryen këto punë:

1. Aprovon statutin,
2. Rregulloren e kuvendit ,
3. Rregulloren e bordit
4. Rregulloren e komisionit mbikqyres,
5. Miraton raportet e punës të organeve të veta,
6. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin, dy nënkryetarë dhe anëtarët tjerë të Bordit,
7. Zgjedh dhe shkarkon Këshillin Mbikqyrës,
8. Vendosë në lidhje me mjetet e jashtëzakonshme juridike,
9. Vendosë mbi faljen e dënimeve,
10. Aprovon planin financiar të federatës
11. Sajon politikën e federatës,
12. Kryen edhe punë tjera në përputhje me Statutin dhe aktet tjera të federatës.
13. Pranimin për anëtarësim (nëse është e nevojshme);
14. Pezullimin ose përjashtimin e anëtarëve (nëse aplikohet);
15. Shkarkimin e një anëtari të një organi të FBOXK-së (nëse është e zbatueshme);

-VI- BORDI

Neni 27.

Bordi udhëheq me punën e Federatës në mes të dy mbledhjeve të Kuvendit. Mbledhjet i thërret Kryetari e në mungesë të tijë njëri prej dy nënkryetarëve ose Sekretari i përgjithshëm. Mbledhjet janë të rregullta ose të jashtëzakonshme, mbledhja e jashtëzakonshme mund të konvokohet nëse për një gjë të tillë deklarohet shumica e anëtarëve të Bordit.

Neni 28.

Bordi numëron 13 anëtarë dhe përbëhet prej: Kryetarit, dy nënkryetarëve dhe dhjetë antarëve tjerë, prej të cilëve shtate zgjedhen nga kuvendi, ndërsa tre emërohen nga Kryetari. Anëtarët e Bordit zgjedhen nga Kuvendi me mandate kater vjeqar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandatë. Kryetarin, dy(2) nënkryetarët dhe 5 anëtarë i zgjedh Kuvendi, ndërsa 3 anëtarë i zgjedh Kryetari. Kryetarët e Shoqatave të gjyqtarëve dhe trajnerëve automatikisht janë edhe anëtarë të Bordit. Në radhët e personave të propozura për Bordin e FboxK-së , duhet të jenë persona të gjinisë femrore dhe mës së paku 10% nga bashksitë e pakicave etnike që jetojnë në Kosovë. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit bëhet me vota të fshehta. Lista përfshinë emrat e kandidatëve dhe postet e tyre në Bord. Kryetarët e Shoqatave të trajnerëve dhe gjyqtarëve automatikisht janë edhe anëtarë të Bordit të FboxK-së. Kryetari i Bordit është edhe Kryetar i Kuvendit.

Neni 29.

Mënyra e punës dhe procedura e vendimarrjes në Bordin e FboxK-ës, më përfaqësisht rregullohen me Rregullorën mbi punën e Bordit.

Neni 30.

Bordi në fusheveprimtarinë e punës së vetë kryen këto punë:

1. Miraton të gjitha aktet normative që nuk janë në kompetencë të Kuvendit
2. Përgatit mbledhjet e Kuvendit dhe materialin përçjellës,
3. Egzekuton vendimet e Kuvendit,
4. Aprovon listën e zyrtarëve të ndeshjeve
5. Miraton rregulloret e brendshme të Federatës,
6. Rregullorën disiplinore;
7. Rregullorën e garave;
8. Rregullorën për Regjistrimin/licencimin e klubeve, sportistëve, trajnerëve.
9. Rregullorën për kalimin e garuesve nga klubi në klub;
10. Rregullorën e Anti-Dopingut;
11. Rregullorën për shpalljen e laureatëve të vitit;
12. Rregullorën për Kodin Etik
13. Rregullorën për organizimin e garave të FBOXK,
14. Rregullorën Komisionit të ankesave,
15. Të nxjerr dhe të aprovoj rregullore tjera që janë në kompetencë të bordit;
16. Përpilon planin e punës dhe atë financiar të Federatës,
17. Vendos për blerjen ose shitjen e pasurisë së Federatës,
18. Emëron dhe shkarkon Sekretarin e përgjithshëm,
19. Aprovon planprogramin e punës së Këshillit profesional,
20. Emëron dhe shkarkon trajnerët e reprezentacioneve,
21. Aprovon raportet e Këshillave dhe Komisioneve të Bordit,
22. Miraton shtimin e garave, kalendarin dhe propozicionet e garave,
23. Bartë të drejtën e organizimit të garave nën ombrellën e Federatës,
24. Cakton lartësinë e anëtarësisë dhe kotizimeve për anëtarët e Federatës,
25. Cakton lartësinë e taksës për zyrtarë të ndeshjeve,
26. Vendosë për pranimin e punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve në Federatë dhe për lartësinë e pagave të tyre,
27. Emëron dhe shkarkon Këshillat dhe Komisionet e Bordit,
28. Vendos edhe për çështjet tjera të cilat nuk janë në kompetencë të Kuvendit.

Neni 31.

Bordi mund të formojë komisione të përhershme dhe ad hoc, vendos për kompetencat e tyre dhe emëron anëtarët e tyre. Komisionet dhe këshillat për punën e tyre i përgjigjen Bordit. Komisionet-Këshillat e përhershme janë:

1. Këshilli profesional,
2. Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e boksierëve,
3. Komisioni-komisari i garave,
4. Komisioni Disiplinor dhe ai i Etikës prej 5 antarëve

5. Komisioni për shpërblime.
6. Komisioni i ankesave prej 3 antarve
7. Komisioni Ligjislativ prej 3 antarve

-VII-KRYETARI

Neni 32.

Kryetarin dhe dy nënkryetarët i zgjedh Kuvendi me mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat. Njëri nga nënkryetarët duhet të jetë nga radhët e pakicave.

Kryetari në fushveprimtarinë e vetë kryen këto punë:

Kompetencat e Kryetarit të Bordit janë:

1. Kryetari i Bordit të FboxK-së përfaqëson Federatën, thëret senacën e Bordit, udhëheq me seancat e Bordit dhe të Kuvendit.
2. Nënshkruan vendimet e Bordit e të Kuvendit,
3. Kujdeset për zbatimin e plotë të programeve të punës dhe atyre financiare,
4. Nënshkruan Vendimet dhe konkluzat e Bordit dhe të Kuvendit,
5. Ka të drejtë vetoje në Vendimet e Bordit dhe organeve tjera deri në seancën e parë të Kuvendit,
6. Merrë Vendime në kushte të jashtzakonshme kur nuk mund të mbledhet Bordi apo
7. Kuvendi dhe i njofton këto organe në momentin e parë të mundshëm,
8. Ka të drejtë të largojë nga Bordi çdo anëtar të tij, nëse nuk është aktiv apo nuk vepron në frymën e akteve normative të FboxK-së dhe synimeve të saj, deri në seancën e parë të Kuvendit,
9. Kryetari për punën e vetë i përgjigjet Kuvendit të FboxK.
10. Kryetari mund të shkarkohet edhe para skadimit të afatit zgjedhor me humbjen e besimit ose me krkesën e vetë.
11. Për shkarkimin e kryetarit, vendoset nëse me vota deklarohen mbi 2/3 e numrit të delegatëve të pranishëm në Kuvend.
12. Propozon Sekretarin e FboxK-së dhe kryen edhe punë tjera sipas nevojës dhe kërkesave që kërkon momenti dhe Kuvendi apo Bordi.

-VIII-SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Neni 33.

Sekretarin e përgjithshëm e emëron Bordi me vendim pune pa afat të kufizuar

Neni 34.

Sekretari i përgjithshëm në fushveprimtarinë e vetë i kryen këto punë:

1. Udhëheq me punën e zyrës së Federatës,
2. Egzekuton vendimet e Kuvendit, Bordit dhe të Komisioneve të Federatës,
3. Realizon bashkëpunimin me EABA dhe, IBA dhe me Federatat dhe organizatat tjera sportive jashtë Kosovës,
4. Realizon bashkëpunimin me KOK-un, Departamentin e Sporteve dhe organizatat tjera sportive në Kosovë,
5. Prgatitë mbledhjet e Kuvendit, Bordit, të Këshillave dhe Komisioneve,
6. Mer pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve, Këshillave dhe komisioneve të Federatës në cilësinë e këshilldhënësit.
7. Mban kontakte me mjetet e informimit,

8. Propozon Bordit, profilin e bashkëpunorëve profesional-administrativë,
9. Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga aktet tjera normative të FboxK-ës.
10. Menaxhon me financat e Federatës'
11. Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për punën administrative të FBOXK
12. Administrimin dhe mbajtjen e llogaris së FBOXK

Neni 35.

Sekretari i përgjithshëm themelon marrëdhënie të punës me Federatën në bazë të Ligjit mbi marrëdhënie të punës.

Sekretari i përgjithshëm mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit të tij, në qoftëse nuk i kryen

obligimet të cilat dalin nga aktet normative.

Sekretarin e përgjithshëm në rastë të mungesës së tij e zëvendëson personi të cilin e cakton Bordi.

-KËSHILLI MBIKQYRËS-

Neni 36.

Këshilli mbikqyrës përbëhet prej tre anëtarëve. Këshillin mbikqyrës e zgjedhë Kuvendi me mandat katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandate.

Anëtari i këshillit mbikqyrës nuk mund të jetë anëtarë i organeve dhe trupave të Federatës.

Bordi dhe të gjitha trupat e tij janë të obliguara që Këshillit mbikqyrës ti a mundësojnë mbikqyrjen në punën e tyre.

Këshilli mbikqyrës përcjell ligjshmerine punës se Bordit, organeve dhe trupave në mes të dy Kuvendeve

dhe mbikqyrë afarizmin financiar të Federatës.

Këshilli mbikqyrës i raporton për punën e vetë Kuvendit të FboxK-ës.

Mënyra e punës së Këshillit mbikqyrës më përfaqësohet përcaktohet me Rregullorën mbi punën e Këshillit mbikqyrës.

-KËSHILLI PROFESIONAL-

Neni 37.

Këshilli profesional është organ profesional i Federatës, i cili kujdeset për zhvillimin profesional të boksit. Këshilli profesional numron tre anëtarë, të cilët i emëronë Bordi me mandat katër vjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandate. Për punën e vetë i përgjigjet Bordit.

Të drejtat dhe obligimet e Këshillit profesional janë:

1. Të përcjellë zhvillimin e boksit mbrenda dhe jashtë,
2. Të mbikqyrë realizimin e planprogrameve të aprovuara nga Bordi,
3. Kujdeset për zhvillimin profesional dhe popullarizimin e boksit,
4. Bashkëpunon me organizatat profesionale dhe shkencore me qëllim të përparimit të punës profesionale,
5. Propozon Bordit emërimin dhe shkarkimin e trajnerëve të Reprerentacioneve,
6. Kujdeset për përparimin profesional të trajnerëve,
7. Propozon Bordit aprovimin e planprogrameve për zhvillimin e boksit,

8. Propozon sistemet e garave për të gjitha grupmoshat,
9. Kryen edhe punë tjera me të cilat i ngarkon Bordi.

-KOMISIONI PËR REGJISTRIM-

Neni 38.

Komisioni për regjistrim numëron tre anëtarë, të cilët i emëronë Bordi me mandat katër vjeçar, me të drejtën rizgjedhjes edhe për një mandatë.
Komisioni për kalimin dhe regjistrimin e boksierëve regjistron boksierët gjatë afateve kalimtare dhe vendos për çështjet statusore të boksierëve.
Komisioni merr vendime me shkrim për regjistrimin ose mosregjistrimin e boksierëve gjatë afateve kalimtare.
Komisioni i merr vendimet në bazë të Rregullorës për kalimin dhe regjistrimin e boksierëve dhe Ligjeve në fuqi.
Statusi i boksierëve rregullohet më përafërsisht me Rregullorën për kalimin dhe regjistrimin e boksierëve.

-KOMISIONI I GARAVE-

Neni 39.

Komisioni i garave në fushveprimtarinë e vetë i kryen këto punë:

1. Propozonë propozicionet e garave,
2. Propozonë kalendarin e garave,
3. Regjistronë objektet në të cilat do të zhvillohen ndeshjet kampionale,
4. Në përputhje me Propozicionet e garave, regjistron meqet dhe turnet kampionale dhe vendos në shkallë të pare në lidhje me ankesat në meqe,
5. Propozon lartësinë e taksave për zyrtarë të ndeshjeve,
6. Zbaton sanksionet e parapara në propozicione të garave,

Neni 40.

Të gjitha vendimet në Këshillat dhe Komisionet e Federatës mirren me shumicën e votave.
Vendimet e Këshillave dhe Komisioneve janë të plotfuqishme në qoftëse në mbledhje janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.
Anëtari i Këshillit apo Komisionit të FboxK-ës i cili nuk është prezent në mbledhje mundë të deklarohet edhe me shkrim, nëpërmjet postës elektronike apo telefazit.

-KOMISIONI I ANKESAVE

Neni 41.

Komisioni I ankesave përbehet prej 3 antarve të cilët i emëron Bordi I Fboxk-së

Komisioni I ankesave është i obliguar të zgjidh ankesën në afatin prej tridhjetë (30) ditëve. Komisioni i ankesave përbëhet prej tre anëtarëve, të cilët i emëronë Bordi me mandat katër vjeçar, me të drejtën e rizgjedhjes edhe për një mandatë. Komisioni i ankesave vendosë në shkallë të dytë në lidhje me shkeljet e Rregullorës së ankesave, me të cilën më përafërsisht rregullohen të drejtat dhe obligimet e Komisionit, si dhe procedura e vendimmarrjes në lidhje me ankesat. Komisioni i ankesave i merr vendimet në bazë të rregullores disiplinore. Komisioni i ankesave vendimet i merr kur janë present të gjithë antarët dhe nuk kanë të drejtë apstenimi.

KOMISIONI I DISIPLINOR DHE I ETIKËS

Neni 42

1. Komisioni i Disiplinor dhe i Etikës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, kryetari dhe dy anëtarë.
2. Komisioni i Disiplinor dhe Etikës, si rregull, shqyrton çështjet në trupa gjyquese me tre anëtarë.
3. Funkzioni i Komisionit të Disiplinor dhe Etikës rregullohet nga Rregulloja Disiplinore dhe Kodi i Etikës i FboxK-së.
4. Komisioni i Disiplinor dhe Etikës mund të japë sanksionet e përshkruara në këtë statut dhe rregulloren e komisionit Disiplinor dhe Kodin Etikës të FboxK-së për anëtarët, zyrtarët, triathletët, klubet, etj.
5. Këto dispozita nuk prekin kompetencat e Kuvendit të Përgjithshëm dhe Bordit në lidhje me pezullimin dhe përjashtimin e anëtarëve.

KOMISIONI SHENDETSOR DHE ANTDOPING

Neni 43.

1. Komisioni shendetsor përbëhet prej tre anëtarëve të zgjedhur nga bordi, me mandatë katër vjeçar, më të drejtë të rizgjedhjes edhe për një mandatë.
2. Komisioni shendetsor ka për detyrë të kujdeset dhe të ruaj shëndetin e boksiereve. Këtu përfshihet edhe sporti të mbetet i pastër, pra që të ndalohet përdorimi i mjeteve të ndaluara stimuluese (dopingut).
3. Komisioni ka për detyrë të marrë informatat e përditësuara për listën e substancave të ndaluara dhe me ato të njoftojë të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet e FBOXK-së. Po ashtu komisioni ka për detyrë përcjelljen e të arriturave në mjeksinë sportive, për të mundësuar zhvillimin dhe avansimin e boksit.

Neni 44

KOMISIONI LEGJISLATIV

Komisioni Legjislativ mbikëqyr respektimin, propozon plotësimin ndryshimin e statutit dhe rregulloreve të FBOXK përmes azhurnimit të normave juridike në përputhje me standardet e Federatës Botërore/Evropiane të Boksit, Ligjin për sport, Ligjin për organizata jo qeveritare, Ligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në sport, me propozim të Bordit të FBOXK. Komisioni Legjislativ përbëhet nga një kryetar dhe dy anëtarë, ku njëri prej tyre duhet të jenë me fakultet juridik.

-KOMISIONI PËR SHPËRBLIME DHE LAURATË

Neni 45.

FBOXK-ja në baza vjetore shpall Laureatët e Vitit. FBOXK ndan mirënjohje dhe shpërblime në shenjë të mirënjohjes për kontribut të veçantë ndaj një bokseri, klubi, gjyqtarëve, puntorëve sportive etj. në promovimin dhe zhvillimin e sportit të boksit

Me Rregulloren përkatëse për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve përcaktohen procedurat, kushtet, mënyra e propozimit dhe e miratimit të kandidatëve.

-IX-DISPOZITAT FINANSIARE

Neni 46.

Federata finansohet nga:

- Anëtarësia,
- Donacionet e personave fizik dhe juridik,
- Marketingu,
- Të hyrave nga organizimi i garave dhe
- Burimet tjera të lejuara në bazë të Ligjit.

Neni 47

KONFLIKTI I INTERESIT

- 1.Çdo anëtar i organeve duhet të tërhiqet nga diskutimet dhe nga marrja e një vendimi nëse ekziston rreziku ose mundësia e konfliktit të interesit.
- 2.Në veçanti, anëtarët e organeve duhet të jenë gjithmonë të vetëdijshëm dhe të veprojnë në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Etikës të IBA-s mbi konfliktin e interesit dhe të rregullojnë sjelljen e tyre kur është e nevojshme (p.sh. të abstenojnë nga kryerja e detyrave të tyre, të njoftojnë kryetarin në rastet e konflikteve të mundshme të interesit, etj.).
- 3.Kryetari dhe Sekretarin e Përgjithshëm nuk mund të jenë njëkohësisht edhe Kryetar i klubit që është anëtarë në FBOXK.
4. Bordi do të nxjerr rregullore mbi konfliktin e interesit.

Neni 48.

Me afarizmin financiar të Federatës udhëheq Kryetari në bazë të planit financiar dhe vendimeve të Kuvendit dhe Bordit.

Për ndihmë në realizimin e afarizmit të Federatës,mundë të punësohet referenti financiar në përputhje me Ligjin mbi mardhënjën e punës.

-X-GARAT

Neni 49.

Garat zyrtare në Kosovë mundë të organizohen vetëm nga Federata, ose organi i autorizuar nga Bordi i sajë.

Garat zhvillohen në bazë të rregullave të EABA - IBA dhe rregulloreve të FboxK-ës.

Në udhëheqjen e garave organi përkatës i garave duhet ti respektoj të gjitha vendimet e EABA-se dhe IBA-se.

Fillimin, shtyerjën, propozicionet e garave kampionale dhe turneve i miraton Bordi i FboxK-ës.

-XI-REPREZENTACIONE

Neni 50.

Federata është e obliguar që të kujdeset për punën e Reprerentacioneve dhe brenda mundësive finansiare

duhet tu mundësoj kushte sa më të mira për punë.

Paraqitja për Reprerentacionin e Kosovës është obligim dhe nderë për çdo anëtarë të sajë.

Federata mundë të miratoj rregullore të posaqme për punën e reprerentacioneve.

-XII-SHËRBIMI ADMINISTRATIVO-PROFESIONAL

Neni 51.

Federata mundë të themeloj mardhënje të punës me punëtorët të cilët do të punojnë në shërbimin profesional dhe administrative të Federatës. Për punësimin e punëtorëve dhe për lartësinë e pagave vendos Bordi me propozim të Sekretarit të përgjithshëm.

Federatat mund të punësoi zyrtar për kryerjen e punëve në administratë, zyrtar profesional i cili do të mbajë kontakte me shoqatën e trajnerëve dhe gjyqtarëve, përfaqësuesve, Eubc-në dhe IBA-në, si dhe asociacionet tjera ndërkombëtare për zhvillimin e garave dhe aktiviteteve në rrafshin ndërkombëtar.

- Federatat mund të punësoi zyrtar për kryerjen e punëve në administratë, zyrtar profesional të IT, dizajnit dhe mirëmbajtjes së Web-faqes dhe rrjeteve sociale.

-XIII-RREGULLORET E BRENDSHME-

Neni 52.

Rregulloret e brendshme dhe propozicionet e garave nuk guxojnë të pësojnë ndryshime, gjatë edicionit garues i cili është në rrjedhën e sipër.

Neni 53.

Në procedurat administrative të cilat zhvillohen pranë organeve kompetente të Federatës mundë të përdoren

mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Për çështjet administrative të cilat nuk janë rregulluara me këtë Statut, do të aplikohen dispozitat e Kodit mbi procedurat administrative. (Deri në miratimin e Kodit të sipërpërmendur do të aplikohen dispozitat e Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative).

Neni 54

SHPËRBËRJA E FEDERATËS

Federata pushon së vepruari kur 2/3 e anëtarëve të Kuvendit dhe nënshkruesit e marrëveshjes mbi bashkim në organizatat e boksit, kontestojnë se nuk ekzistojnë kushtet materiale dhe shoqërore për veprimtarinë e mëtejme dhe sipas forcës së Ligjit. 15.7.1. Në rast ë pushimit të veprimit të Fboxk-së, e gjithë pasuria e saj (aktive dhe pasive) i kalojnë trupit qeveritar apo organizatës e cila e merr përsipër te drejtat dhe detyrat e federatës dhe cila është në dispozicion të organizatave të boksit për përparimin e këtij sporti.

-XIV-DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 55.

Ky Statut hunë në fuqi ditën e aprovimit,nga Kuvendi i Federatës me 05 Maj 2022.Më hyrjën në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i miratuar ne tetor 2019.

-Nëse ky Statut ne ndonjë pike has ne kundërthënies me Ligjin për sport, Ligjin për parandalimin e dhunës në sport dhe aktet tjera nënligjore apo udhëzimet te cilat dalin nga MKRS atëherë vlejnjë dispozitat e akteve normative që dalin nga Ligji për sport, Ligji për parandalimin e dhunës në Sport dhe udhëzimeve tjera administrative.

Neni 56.

Interpretimin e këtij Statuti e bënë Kuvendi i Federatës.

Kryetari i FboxK-së

Enver Krasniqi



Prishtinë më 05.05.2022